



BASHKIA KUÇOVË

Data ____/ ____/ 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT :

“Rikualifikim i lulishteve, wc publike dhe shesheve mes pallateve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi 45 (punë ndërtimore).

VLERA E FONDIT LIMIT :

30 006 089,29 *(tridhjetë milion e gjashtë mijë e tetëdhjetë e nëntë,presje njëzetë e nëntë)* Lekë pa TVSH
lekë pa tvsh.

- Fondi limit për : “Rikualifikim i sheshit mes pallateve pranë shkollës Dëshmorët e Kombit, lagja nr 2 blloku 1 Maj” është : 4 825 280,75 *(katër milion e tetëqind e njëzetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë presje shtatëdhjetë e pestë)* lekë pa TVSH.

- Fondi limit për “Rikualifikim i sheshit mes pallateve në rrugën ‘Niko Hoxha’ lagja nr 2 blloku 11 Shkurti” është : 5 133 042,40 *(pesë milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e dyzetë e dy presje dyzetë)* lekë pa TVSH.
- Fondi limit për “Rikualifikim i sheshit mes pallateve në rrugën ‘Naftëtari’ pranë ambulancës së lagjes ‘Llukan Prifti’” është : 2 873 589,6 *(dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë presje gjashtë)* lekë pa TVSH.
- Fondi limit për “Rikualifikim i sheshit mes pallateve pranë shkollës ‘Myrteza Kepi’ lagja nr 2 blloku ‘Llukan Prifti’” është : 3 923 199,43 *(tre milion e nëntëqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje dyzetë e tre)* lekë pa TVSH.
- Fondi limit për “Rikonstruksion i lulishtes dhe wc publike pranë Bashkisë Kuçovë dhe rikonstruksion i lulishtes dhe wc publike pranë parkut të ri” është : 8 584 497,62 *(tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë presje gjashtëdhjetë e dy)* lekë pa TVSH.
- Fondi limit për “Rikualifikimi i sheshit pranë ish NPA-së Lagja Llukan Prifti” është : 4 666 479.49 *(katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë presje dyzetë e nëntë)* lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë :

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertes sipas shtojces 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore (Sipas QKB) për vitin 2026 sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
 2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
 3. Taksa e fjetjes në hotel.
 4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
 5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
 6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
 7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
 8. Taksa e tabelës.
 9. Taksa të përkohshme.
-

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
 - b) **vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**
 - c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.
-

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros qëmund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji".

2.2.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar

legjislationit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime,

për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:
 - a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
 - b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
 - c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*
 - d) *Akt Kolaudimi*
 - e) *Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore*
- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:
 - a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
 - b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
 - c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse.*
 - d) *Akti i Kolaudimit*
 - e) *Faturat tatimore, Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshëm për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo më e vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël **180%** të vlerës së fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP.1 – A Punime Germimi ne toke

N.P. 4 – A Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P. 1 A (Punime gjurmimi në tokë)

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Duke analizuar preventivin e punimeve, liçensa e mësipërme përkon me punimet si 3.89/a Gjurmim dhe me eskavator me goma 0.25 m³ në kanale gjerësi deri në 2 m tokë zak, kategoria III me shk në mjet për objektet : “Rikualifikimi i sheshit mes pallateve në rrugën Niko Hoxha Lagja Nr.2 Blloku 11 Shkurti”, “Rikualifikimi i sheshit mes pallateve pranë shkollës Deshmoret e Kombit Lagja Nr.2, blloku 1 Maj”, si dhe për objektin Rikualifikimi i sheshit pranë ish NPA-se, Lagja Llukan Prifti.

Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të VKM-së nr. 42, është vënë dhe kategoria A për të gjitha kategoritë e kërkuar sipas nivelit nga 0 deri në 20 milion lekë .

NP- 4 A (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet,

devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, **punime të mureve mbajtëse**, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Duke parë dhe vetë objektin e prokurimit i cili është “Rikualifikim i lulishteve, wc publike dhe shesheve mes pallateve” kjo kategori ndërtimi përkon dhe është në përputhje dhe vëllim të plotë me investimin që do të kryhet (e cila përshtatet me zërat e preventivit të punimeve).

Në vijim të objektit të prokurimit, qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është shtrimi i shesheve mes pallateve si dhe të lulishteve duke i siguruar banorëve të zonës kushte më të mira jetesë. Bazuar dhe nga preventive i punimeve ku përfshin punë të tilla si psh, shtresë çakëlli mbeturina kave t=10cm përhapur e ngjeshur me makineri, shtresë stabilizanti 10cm, shtresë asfaltbetoni me zall lavatriçe 7cm me makineri etj, të cilat janë në përputhje me liçensën e mësipërme të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të VKM-së nr. 42, është vënë dhe kategoria A për të gjitha kategoritë e kërkuar sipas nivelit nga 0 deri në 20 milion lekë .

.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS - 18 A (Punime Topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh)

Referuar natyrës së punimeve të mësipërme për këto të fundit, shfaqet e nevojshme disponueshmëria e kategorive të licencës për zbatim NS 18 - A, si punime të cilat përfshihen në grupin e punimeve parashikuar në lidhjen nr.3 të Vendimit 17 nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Ku kjo kategori kër kohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, sheshe, lulishte, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gërmim kanali etj sepse ai merret me rievimit e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet.

Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të VKM-së nr. 42, është vënë dhe kategoria A për të gjitha kategoritë e kërkuar sipas nivelit nga 0 deri në 20 milion lekë .

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë në datën e hapjes së ofertave, si më poshtë :

1) Inxhinier Ndërtimi Profili Transport	1 (një)
2) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder	1 (një)
3) Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
4) Inxhinier Elektrik	1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë në datën e hapjes së ofertave.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontrate pune e vlefshme, diplomë, (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e

ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshem disponueshmëria i një Inxhinier profili transport, Topograf, dhe Hidroteknik, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshem.

➤ **Inxhinier Ndërtimi Profili Transport 1 (një)**

Duke analizuar preventivin e punimeve, si dhe referuar objektit të prokurimit i cili është “Rikualifikim i lulishteve, wc publike dhe shesheve mes pallateve”, disponueshmëria nga ana e operatorëve ekonomik ofertues të një inxhinier ndërtimi, si dhe mendimi i tij i specializuar ndihmon në zbatimin e kontratës me sukses duke arritur qëllimin e autoritetit kontraktor që përpos punimeve që do të kryhen, të kryejë një rrugë me standarte midis shesheve të pallateve dhe punime sipas kushteve teknike, në përputhje me cilësinë që kërkon autoriteti kontraktor. Duke analizuar preventivin e punimeve, ku parashikohet Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 7cm, me makineri për disa sheshe, shtresë stabilizanti si dhe shtresë çakulli.

Inxhinieri i Ndërtimit, Profili Transport, është i nevojshëm për drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen teknike të punimeve rrugore. Ai siguron zbatimin e punimeve sipas projektit, kontrollon kuotat, nivelet, shtresat rrugore, procesin e asfaltimit dhe cilësinë e punimeve, duke koordinuar njëkohësisht makineritë dhe ekipet në kantier.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për një inxhinier ndërtimi profili transport, është një kërkesë në përputhje me preventivin e punimeve dhe garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

➤ **Inxhinier Hidroteknik 1 (një)**

Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierit Hidroteknik, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshem disponueshmëria i një Inxhinier Hidroteknik, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, parë kjo në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e punimeve, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshem .

Duke analizuar preventivin e punimeve, inxhinieri i mësipërm përkon me punimet në zërat përkatës si F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm > në sasinë 300 ml për objektin Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Deshmoret e Kombit, Lagja Nr.2, blloku 1 Maj, F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm > në sasinë 850 ml, F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110 > në sasinë 15 ml, F.V. për objektin “Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri”, si dhe zërat F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm > në sasinë 150 ml për objektin “Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Myrteza Kepi Lagja Nr.2 , Blloku Llukan Prifti”, etj.

➤ **Inxhinier Topograf 1 (një)**

Inxhinier topograf kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, sheshe dhe lulishte rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gërmim kanali etj sepse ai merret me rilevimit e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

➤ **Inxhinier Elektrik 1 (një)**

Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierit Elektrik, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshem disponueshmëria i një Inxhinier Elektrik, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, parë kjo në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e punimeve, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshem.

Duke analizuar preventivin e punimeve, inxhinieri i mësipërm përkon me punimet në zërat përkatës për objektin : Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Deshmoret e Kombit, Lagja Nr.2, blloku 1 Maj, si :

TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA

3.170	F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	copë	9
3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	9
3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	9
3.175	F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V	copë	9
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm	copë	9

INSTALIME PER NDRICIM

2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	250
2.480/5	F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	150

Për Objektin :Rikualifikimi i sheshit mes pallateve ne rrugen Niko Hoxha , Lagja Nr.2 , Blloku 11 Shkurti

TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA

3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	10
3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	10
3.175	F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V	copë	10
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm	copë	10

INSTALIME PER NDRICIM

2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	500
2.480/4	F.V. Tub plastmasi Ø 27-30mm	ml	500

Për Objekti:Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Myrteza Kepi, Lagja Nr.2 , Blloku Llukan Prifti

TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA

3.170	F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	copë	8
3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	8
3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	8

3.175	F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V	copë	8
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm	copë	8

2

INSTALIME PER NDRICIM

2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	450
---------	----------------------------------	----	-----

Për objekti: Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri.

	2. INSTALIME PER NDRICIM		
2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	850
2.480/5	F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	300
2.485/1	F.V. Çeles 1 polar 220V 10A	copë	8

	10. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.176	F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	copë	40
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm	copë	40

Për Objekti: Rikualifikimi i sheshit prane ish NPA-se, Lagja Llukan Prifti

	5. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.170	F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	copë	9
3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	9
3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	9
3.175	F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V	copë	9
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm	copë	9

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë si staf mbështetës, në listëpagesën e shoqërisë në datën e hapjes së ofertave si më poshtë :

- Inxhinier mjedisi

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin :

- kontrate pune e vlefshme,
- diplomë,

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierit të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme prania e tyre, parë kjo në raport edhe me edhe me volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

- **Inxhinier Mjedisi 1 (një)**

Është përgjegjës për zbatimin e zërave të preventivit për punime gërmimi, ndërtimi i terreneve të jashtme, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjatë zbatimit të projektit në realizimin e plotë të kontratës, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale.

Bazuar edhe në specifikimet teknike të hartuar, është parashikuar dhe mbrojtja e ambientit.

Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjent lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë dhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mosplotësimi i kësaj klauzole në bazë të evidentimit nga mbikqyrësi i punimeve mund të çojë në ndërprerjen e kontratës.

Në seksionin “Pastrimi përfundimtar i zonës”.

Në përfundim të punës sa herë që është e aplikueshme sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa përfundimtare e kontratës do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi jepet miratimi nga mbikëqyrësi i punimeve.

Akoma më tej njësia e prokurimit e ka lënë të hapur plotësimin e kriterit të sipërcituar, duke lejuar disponueshmërinë e tij edhe në listëpagesat e shoqërisë, jo domosdoshmërisht si drejtues teknik i shoqërisë.

2.3.5 Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar / të kualifikuar, për të paktën muajin e fundit si staf teknik punonjës si më poshtë :

Nr	STAF TEKNIK	Nr i punonjësve
1	Teknik Ndërtimi	1 (një)
2	Teknik Gjeodet/Topograf/Gjeomatik	1 (një)
3	Karpentier	2 (dy)
4	Betonues	3 (tre)
5	Specialist ndertimi (per punime te pergjithshme)	3 (tre)
6	Punonjes Asfalti	3 (tre)
7	Eskavatorist	1 (një)
8	Shofer	1 (një)
9	Automakinista	1 (një)
10	Buldozeriste	1 (një)
11	Elektracist	3 (tre)

12	Hidraulik	2 (dy)
13	Pllakashtrues	3 (tre)
14	Bojaxhi	1 (një)
15	Suvatues	1 (një)
16	Hidroizolues	1 (një)
17	Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë	1 (një)
	Totali 29 (njëzetë e nëntë) punonjës	

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.

Përpara lidhjes së kontratës për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë :

Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ***ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)***, kontrate pune e vlefshme.

Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR.

Në rastin kur mjetet e kërkuar më poshtë në pikën **2.3.8** janë me qera nuk është kusht që shoferët të jenë në listpagesën e shoqërisë, ata do të lejohen të plotësohen nga ofertuesit **edhe nëpërmjet kontraktimit për këtë objekt prokurimi.**

Argumentimi në lidhje me pikën 2.3.4. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit sqaron se të gjithë punonjësit e kërkuar si më sipër me dëshmi kualifikimi të

sigurimit teknik apo çertifikata ekuivalente të tyre, përkojnë me punimet sipas preventivit të publikuar në SPE, dhe konkretisht :

Akoma më tej, kriteri i mësipërm është lënë i hapur për tu plotësuar nga ofertuesit për shoferët dhe manovratorët për sa kohë disponimi i tyre lejohet të përmbushet edhe nëpërmjet nënkontraktimit në rastet kur mjetet e kërkuar më poshtë sipas pikës 2.3.8 janë me qera.

Referuar volumit të punimeve, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër të arsyeshëm manovratorësh me qëllim zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- **Për teknik ndërtimi** 1 (një) punonjës, **për Karpentier 2 (dy)** punonjës dhe **Betonues 2 (dy)** punonjës të pajisur me dëshmi aftësie profesionale, nevojitet prezenca e tyre në kantier duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime për sistemimin e shtresës së çakullit dhe stabilizantit në sheshet mes pallateve përpara ngjeshjes së saj me makineri, Referuar preventivit të punimeve ku parashikohen punime si Shtrese betoni C 16/20, Mur betoni C 16/20, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish për zbatimin e këtyre zërave duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

Për objektin : “Rikualifikim i sheshit mes pallateve në rrugën ‘Naftëtari’ pranë ambulancës së lagjes ‘Llukan Prifti’”

Është parashikuar punime si F.V. Bordura betoni 15x25cm në sasinë 160 m

Për objektin : Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri.

Është parashikuar punime si F.V. Bordura betoni 15x25cm në sasinë 600 m

Referuar volumit të punimeve si dhe punime si Shtrese betoni C 16/20, Mur betoni C 16/20, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër proporcional në raport me objektin e kontratës, dhe ka miratuar kriterin për 2 (dy) punonjës betonues.

- **Për teknik ndërtimi** 1 (një) punonjës të pajisur me dëshmi aftësie profesionale, nevojitet prezenca e tij në kantier duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime për sistemimin e shtresës së çakullit pas mureve, shtresë stabilizanti si dhe të strukturave monolite të betonit. Funksione të cilat nevojiten të kryhen në të sheshet mes pallateve ku do të kaloi investimi.

- **Për Karpentier 2 (dy) punonjës** njësia e prokurimit gjykon se domosdoshmëria e këtij punonjësi është i nevojshëm për zbatimin e punimeve të parashikuar në preventiv si :
Shtrese betoni C 16/20, Mur betoni C 16/20, nevojiten minimumi 2 (dy) punonjës karpentier për montimin e armaturës dhe kallëpeve. 2 (dy) karpentierë është më e arsyeshme për punë normale në kantier, sepse njëri mund të mbajë/fiksojë elementin ndërsa tjetri e monton ose e pozicionon.

- **Për Teknik Gjeodet/Topograf/Gjeomatik 1 (një) punonjës** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të sistemimit të jashtëm, sepse kemi punime të cilat kërkojnë precizion në kuota dhe nivele të caktuara ku duhen montuar strukturat e betonit apo elementet e ndryshëm dhe ata duhet të lexojnë projektin dhe kryejnë matjet e nevojshme. Tekniku topograf do të zbatojë punimet e objekt kontratës në përputhje me parashikimet teknike të autoritetit kontraktor, nën udhëheqjen e inxhinierit topograf. Akoma më tej, kur kemi të bëjmë edhe me shtrimin e disa rrugica dhe shesheve mes pallateve, prezenca e tij në kantier garanton AK për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

- **Specialist ndërtimi (per punime te pergjithshme)**

Specialisti i ndërtimit është i nevojshëm për realizimin dhe mbështetjen e punimeve të përgjithshme në kantier, duke marrë pjesë në përgatitjen e zonave të punës, sistemimin e materialeve, punimet ndihmëse dhe realizimin e detajeve të ndryshme ndërtimore. Ai bashkëpunon me inxhinierët, karpentierët dhe punëtorët e tjerë për zbatimin korrekt të punimeve dhe respektimin e kërkesave teknike.
Në kuadër të punimeve rrugore, specialisti mund të angazhohet në përgatitjen e bazamentit, punime ndihmëse gjatë gërmimeve, betonimeve, vendosjes së elementëve anësorë dhe përgatitjes së zonave për asfaltim. Përdorimi i tij siguron mbështetje të vazhdueshme për ekipet e kantierit dhe kontribuon në organizimin, cilësinë dhe ecurinë normale të punimeve.
Referuar zërave të punimeve si shtresës së çakullit, shtresë stabilizanti, Shtrese rere natyrore t=10cm etj, NJP gjykon se kërkesa e mësipërme është në proporcion me objektin e kontratës.

- **Për Punonjes Asfalti 3 (tre) punonjës** njësia e prokurimit gjykon se këta punonjës janë të domosdoshëm për të arrituruar qëllimin autoriteti kontraktor për punime si shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7 cm, me makineri në sasi 1450 m² për objektin Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Deshmoret e Kombit, Lagja Nr.2, blloku 1 Maj, si dhe shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7 cm, me makineri në sasi 1500 m² për objektin Rikualifikimi i sheshit mes pallateve ne rrugen Niko Hoxha, Lagja Nr.2, Blloku 11 Shkurti, si dhe shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7 cm, me makineri në sasi 1500 m² për objektin 1100
Në total 4 050 m² asfalt.
Lidhur me volumin e punimeve në të cilën do të kryhet investimi i Bashkisë Kuçovë, njësia e prokurimit gjykon se punonjësit e mësipërm garantojnë AK për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë. Referuar grafikut të punime, ku asfalti do të hidhet për 1 muaj (në muajin e fundit, kërkesa e AK është në përputhje me vëllimin e punimeve dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor.

Referuar dhe volumit të punimeve, 4 050 m² asfalt, dhe grafikut të punimeve ku parashikohet të kryhen për 1 muaj këto zëra, NJP ka kryer një analizë të detajuar si më poshtë :

Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7cm me makineri 4 050m²

Nga një përlogaritje e thjeshtë vërehet se ;

Nga manuali i çmimeve të ndërtimit për këtë zë shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7cm, rezulton se është 0.134 orë pune për njësi, dhe totali për 4 050 m² = 542,7 orë pune në total.

Nga mbledhja e orëve të punës për shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7cm, në total janë 542,7 orë pune për përfundimin e punimeve me sukses për shtrimin e rrugës me asfalt.

Në grafikun e punimeve është parashikaur që punimet e hekurit janë për tu zbatuar në 1 (një) muaj.

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës),

542,7 orë pune (për punimet e betonit) : 208 orë totali për 1 muaj. = 2.6 punonjës betonues.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 3 (tre) punonjës asfalti.

- **Për Elektricit 3 (Tre) punonjës** njësia e prokurimit gjykon se këta punonjës janë të domosdoshëm për të arritur qëllimin autoriteti kontraktor për punime elektrike si për objektin : Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Deshmoret e Kombit, Lagja Nr.2, blloku 1 Maj, si :

TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA

3.170	F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	copë	9
3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	9
3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	9
3.175	F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V	copë	9
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm	copë	9

INSTALIME PER NDRICIM

2.481/1	F.V. Percielles PV-500 Ø 1.5 mm ²	ml	250
---------	--	----	-----

2.480/5	F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	150
---------	------------------------------	----	-----

Për Objektin :Rikualifikimi i sheshit mes pallateve ne rrugen Niko Hoxha , Lagja Nr.2 , Blloku 11 Shkurti

TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA

3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	10
3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	10
3.175	F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V	copë	10
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguar 50x3mm L=150cm	copë	10

INSTALIME PER NDRICIM

2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	500
2.480/4	F.V. Tub plastmasi Ø 27-30mm	ml	500

Për Objekti:Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Myrteza Kepi, Lagja Nr.2 , Blloku Llukan Prifti

TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA

3.170	F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	copë	8
3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	8
3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	8
3.175 ²	F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V	copë	8
3.182 ^{I N}	F.V. Elektroda tokezimi te xinguar 50x3mm L=150cm	copë	8

S

INSTALIME PER NDRICIM

2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	450
---------	----------------------------------	----	-----

Për objekti: Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri.

	2. INSTALIME PER NDRICIM		
2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	850
2.480/5	F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	300
2.485/1	F.V. Çeles 1 polar 220V 10A	copë	8

	10. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.176	F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	copë	40
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xingura 50x3mm L=150cm	copë	40

	5. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.170	F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	copë	9
3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	9
3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	9
3.175	F.V. Ndricules Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V	copë	9
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xingura 50x3mm L=150cm	copë	9

Referuar volumit të punimeve, si dhe grafikut të punimeve të cilat parashikohen te kryhen në muajin e tretë dhe për 1 (një) muaj në total, njësia e prokurimit gjykon se duke analizuar zërat dhe volumet e tyre, disponueshmëria e tre punonjësve elektrikist garanton AK për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë, nëm udhëheqjen e inxhinierit elektrik duke mbajtur në konsideratë dhe faktin se nuk është një shesh i vetëm ndërtimit.

➤ **Për 2 (dy) punonjës Hidraulik** njësia e prokurimit gjykon se këta punonjës janë të domosdoshëm për të arritur

qëllimin autoriteti kontraktor për punime hidraulike në zërat përkatës si F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm > në sasinë 300 ml për objektin Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Deshmoret e Kombit, Lagja Nr.2, blloku 1 Maj, F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm > në sasinë 850 ml, F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110 > në sasinë 15 ml, F.V. për objektin “Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri”, si dhe zërat F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm > në sasinë 150 ml për objektin “Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Myrteza Kepi Lagja Nr.2 , Blloku Llukan Prifti”, nën udhëheqjen e inxhinierit hidroteknik.

- **Për 3 (tre) punonjës Pllakashtrues** njësia e prokurimit gjykon se këta punonjës janë të domosdoshëm për të arritur qëllimin autoriteti kontraktor për punime si më poshtë :

Për objektin “Rikualifikim i sheshit mes pallateve në rrugën ‘Naftëtari’ pranë ambulancës së lagjes ‘Llukan Prifti’”
Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit në sasinë 680 m²

Për Objekti: Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri.

Veshje me pllake majolike në sasinë 200 m²
Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit në sasinë 660
Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm në sasinë 80

Referuar volumit të punimeve, si dhe grafikut të punimeve të cilat parashikohen të kryhen në 2 (dy) muaj dhe konkretisht punimet do të kryhen në muajin e dytë dhe të tretë, si dhe zëri i preventivit Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit do të kryhen për 4 muaj, njësia e prokurimit gjykon se, disponueshmëria e tre punonjësve pllakashtrues garanton AK për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

- **Për bojaxhi 1 (një) punonjës** njësia e prokurimit gjykon se ky punonjës është i domosdoshëm për të arritur qëllimin autoriteti kontraktor për punime si më poshtë :

Lyerje me hidromat, 2 duar në sasinë 180 m² për objektin Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri.

- **Për suvatues 1 (një) punonjës** njësia e prokurimit gjykon se ky punonjës është i domosdoshëm për të arritur qëllimin autoriteti kontraktor për punime si më poshtë :

Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 në sasinë 200 m²
Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe në sasinë 80 m²
Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm në sasinë 80 m²
për objektin Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri.

- **Për hidroizolues 1 (një) punonjës** njësia e prokurimit gjykon se ky punonjës është i domosdoshëm për të arritur qëllimin autoriteti kontraktor për punime si më poshtë :

Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama në sasinë 80m² për objektin Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri.

- **Për automakinist 1 (një) punonjës, buldozerist 1 (një) punonjës, eskavatorist 1 (një) punonjës, si dhe shofer 1 (një) punonjës.**

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, ku parashikohet shtrimi i shtresës së asfaltobetonit me makineri autobitumatriçe dhe asfaltoshtruese, ku parashikohet shtrimi i lulishteve dhe shesheve me shtresë çakëlli, dhe shtresë stabilizanti, për sheshet mes pallateve, si dhe zëri shtresë asfaltobetonit 7cm, garanton autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të disponojnë drejtues për makineri të rënda për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, për sa kohë disponueshmëria e tyre lidhet drejtëpërdrejtë me manovrimin e mjeteve si Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton 1 (një) copë, Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton 1 (një) copë. Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton 1 copë, Grejder 1 (një) copë, Asfaltoshtruese 1 (një) copë, Autobitumatriçe 1 (një) copë, Rrul ngjeshës me peshë 10- 15 ton 1 (një) copë, Rrul ngjeshës asfalti me peshë deri në 5 ton 1 (një) copë, Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma) 1 (një) copë, Minifadrome (mjet teknologjik me goma) 2 (dy) copë.

Akoma më tej, kriteri i mësipërm është lënë i hapur për tu plotësuar nga ofertuesit për sa kohë disponimi i tyre lejohet të përmbushet edhe nëpërmjet nënkontraktimit në rastet kur mjetet e kërkuar më poshtë sipas pikës 2.3.8 janë me qera.

Referuar volumit të punimeve, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër të arsyeshëm manovratorësh me qëllim zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- **Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**

Njësia e prokurimit e gjykon së kërkesa e mësipërme është në përputhje me objektin e kontratës, për shkak se garantimi i ekspertit së mbrojtjes e shëndetit në punë nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kriteri i mësipërm lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë autoriteti kontraktor ka pranuar edhe disponimin me çertifikata trajnime apo çertifikata ekuivalente të tyre, duke i shërbyer autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës, si dhe duke lehtësuar operatorët

ekonomik ofertues në përmbushjen e këtij kriteri.

Kërkesat e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë", është i nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 34 (tridhjetë e katër) punonjës, dhe të jenë në listëpagesën e shoqërisë në momentin e hapjes së tenderit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për tre muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 .

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, për periudhën **si më sipër**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën

si më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshem për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohej për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj, si dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e punimeve gjithësej 5 (pesë) muaj, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohej për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmerinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka mbajtur në konsideratë Rekomandimin e APP Nr 4916/2 Prot të datë 14.07.2022, pika 3, ku përcaktohet se autoritetet kontraktore duhet të hartojnë kërkesat e veçanta të kualifikimit në përputhje me nenet 77 të LPP dhe 78 të VKM, si dhe legjislacionit të fushës përkatës, duke argumentuar domosdoshmërinë e tyre në çdo rast.

Bazuar mbi rekomandimin e APP, njësia e prokurimit ka hartuar analizën teknike ku parashikohet fuqia punëtore duke u bazuar në preventivin e punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse ka përcaktuar numrin e saktë/ose minimal të punonjësve që nevojiten për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, duke përcaktuar secilin punonjës me kualifikim e duhur, gjithçka në funksion të objektit të kontratës.

Nga përlllogaritja e mësipërme dhe mbledhja e numrin të punonjësve, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 34 (tridhjetë e katër) punonjës të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

2.3.7 Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), **ose ekuivalent**
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), **ose ekuivalent**
- ISO 45001-2023 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme), **ose ekuivalent.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo çertifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe çertifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të leshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qëndrueshëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshem për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën

e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkoj çertifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas çertifikatës iso të mësipërme.

➤ **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalent**

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor.

Kjo çertifikatë është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshem që shoqëritë të jenë të çertifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambientit përreth ku do të kryhet investimi.

➤ **ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose ekuivalentet e tyre**

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë .

Kjo çertifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve . Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime të zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve .

2.3.8 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion kapaciteti mbajtës min 20 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion kapaciteti mbajtës 10-15 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamion kapaciteti mbajtës deri në 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Minifadrome (mjet teknologjik me goma)	copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Minidumper kapaciteti mbajtës 3-8 ton (mjet teknologjik me goma)	copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Kamion me vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Vibrator betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Depozite uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Autobetoniere me kapacitet 2-4 m3 (mjet teknologjik me goma)	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Grejder (mjet teknologjik me goma)	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Autobitumatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Rrul gome-hekur mbi 10-15 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Rrul asfalti deri në 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e kësaj pikës, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik si dhe certifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) si dhe taksat.*
- b) *Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik si dhe certifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme),*

siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre,apo marrjen me qira te tij.(Për mjetet e deklaruarat që transportojnë të klasifikuara të rrezikshme sipas legjislacionit në fuqin, duhet të paraqitet certificate për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).*
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruarat sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese).*
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshem për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kuçovë, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor

kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshem që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor :

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, ku parashikohet Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet në sasinë 200 m³ dhe Transport dheu me auto deri 5.0 km po të njëjtin sasi, shtrimi i shtresës së asfaltbetonit me makineri autobitumatriçe dhe asfaltoshtruese, ku parashikohet shtrimi i rrugës me shtresë çakëlli në sasinë 400 m² , Shtrese stabilizant t=10cm në sasinë 1450 m², si dhe Shtrese asfaltbetoni me zall lavatrice, 7cm, me makineri në sasinë 1450 për objektin Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Deshmoret e Kombit . Lagja Nr.2, blloku 1 Maj,

Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet në sasinë 200 m³ dhe Transport dheu me auto deri 5.0 km po të njëjtin sasi, Shtrese stabilizant t=10cm në sasinë 1500 m², Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri në sasinë 400 m², Shtrese asfaltbetoni me zall lavatrice, 7cm, me makineri në sasinë 1500 m² për objektin Objekti:Rikualifikimi i sheshit mes pallateve ne rrugen Niko Hoxha , Lagja Nr.2 , Blloku 11 Shkurti

Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet në sasinë 100 m³ dhe Transport dheu me auto deri 5.0 km po të njëjtin sasi, Shtrese rere natyrore t=10cm në sasinë 680 m², për objektin “Rikualifikim i sheshit mes pallateve në rrugën ‘Naftëtari’ pranë ambulancës së lagjes ‘Llukan Prifti’”

Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet në sasinë 100 m³ dhe Transport dheu me auto deri 5.0 km po të njëjtin sasi, Shtrese stabilizant t=10cm në sasinë 1100 m², Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri në sasinë 310 m², Shtrese asfaltbetoni me zall lavatrice, 7cm, me makineri në sasinë 1100 m² për Objekti:Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Myrteza Kepi, Lagja Nr.2 , Blloku Llukan Prifti

Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet në sasinë 100 m³ dhe Transport dheu me auto deri 5.0 km po të njëjtin sasi, Shtrese stabilizant t=10cm në sasinë 1410 m², Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri në sasinë 420 m², Shtrese asfaltbetoni me zall lavatrice, 7cm, me makineri në sasinë 1410 m² për Objekti: Rikualifikimi i sheshit prane ish NPA-se, Lagja Llukan Prifti

Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton 1 (një) copë, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton 1 (një) copë, janë të domosdoshëm për transportimin e materialeve të ndërtimit pranë kantierit dhe konkretisht shtresë çakëlli dhe shtresë stabilizanti si dhe shtresë asfaltobetonit.

Referuar volumit të punimeve të cilat janë në sasi të mëdha, NJP gjykon se është e panevojshme të kryej një analizë të detajuar të tyre për sa kohë kemi kërkuar nga 1 mjet.

Duke marrë në konsideratë grafikun e punimeve, shtrimi i rrugës me asfaltobeton me zall lavatriçe 7 cm me makineri, si dhe bazuar në sasinë e parashikuar në preventiv, njësia e prokurimit gjykon se kamionat e kërkuar, janë në përputhje me vëllimin e kontratës dhe nuk shkon përtej qëllimit të AK.

Për Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton 1 copë nevojiten për transportimin e mallrave pranë kantierit të ndërtimit, si dhe për transportimin e tyre brenda kantierit nga njeri vend në tjetrin, duke qenë se kemi disa sheshe ndërtimi njëkohësisht, ku mjetet e mëdha nuk futen dot, ose nuk mund të manovrohen me lehtësi.

Ajo justifikohet për transportet e brendshme dhe ndihmëse brenda kantierit, sidomos kur ka akses të vështirë, segmente të ngushta ose nevojë për shpërndarje të materialeve në pika të ndryshme.

Kamionçina me kapaciteti mbajtës deri në 3.5 ton dot të përdoret për :

- transportimin e materialeve ndihmëse dhe të vogla përgjatë kantierit;
- furnizimin e ekipeve të punës me materiale dhe mjete;
- transportimin e materialeve në segmente ku kamionët 10- 15 ton dhe –20 ton nuk mund të afrohen;
- lëvizjen e materialeve në rrugë të ngushta, degëzime dhe zona me akses të kufizuar;
- transportimin e materialeve të nevojshme për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e zonës së punimeve;
- transportin e materialeve për punime lokale dhe korrigjime të vogla përgjatë frontit të punës;
- mbështetjen logjistike të ekipit të shtrimit.

Për Grejder 1 (një) copë, Eshtë i nevojshëm për hapjen dhe nivelimin e materialeve si cakell dhe stabilizant në rrugë.

Përdorimi i grejderit është teknikisht i nevojshëm për realizimin e punimeve të rehabilitimit dhe përgatitjes së trupit të rrugës, përpara shtrimit të shtresave të asfaltobetonit si shtresë çakulli dhe stabilizanti. Duke marrë në konsideratë sipërfaqen e konsiderueshme të punimeve, përdorimi i grejderit mundëson realizimin e saktë dhe të njëtrajtshëm të punimeve të nivelimit dhe profilimit të rrugës.

Grejderi përdoret për nivelimin, profilimin dhe rregullimin e sipërfaqes së rrugës, duke siguruar kuotat dhe pjerrësitë e kërkuara sipas projektit teknik. Me anë të tehut të grejderit realizohet shpërndarja, nivelimi dhe profilimi i materialit të shtresave rrugore, duke korrigjuar parregullsitë dhe duke krijuar një bazë të njëtrajtshme për vazhdimin e punimeve.

Në kuadër të punimeve të rehabilitimit të rrugës, grejderi mund të përdoret për përpunimin dhe nivelimin e shtresës së nënbazës dhe bazës granulare, për shpërndarjen dhe profilimin e materialit të sjellë në kantier, si dhe për korrigjimin e kuotave dhe pjerrësive tërthore dhe gjatësore të rrugës.

Përdorimi i grejderit është veçanërisht i rëndësishëm për sigurimin e pjerrësisë së nevojshme për drenazhimin e ujërave sipërfaqësore dhe për shmangien e krijimit të zonave me grumbullim uji. Profilimi korrekt i sipërfaqes ndikon drejtpërdrejt në jetëgjatësinë dhe performancën e shtresave të mëvonshme të rrugës.

Grejderi përdoret gjithashtu në bashkërendim me mjetet e tjera të kantierit, veçanërisht me kamionët që sjellin materialin granular, ujitëset dhe rulët e ngjeshjes. Materiali i transportuar nga kamionët shpërndahet dhe profilohet me grejder, më pas laget sipas nevojës dhe ngjeshet me rul për të arritur parametrat e kërkuar të densitetit dhe qëndrueshmërisë.

Në rastin e rehabilitimit të segmenteve ekzistuese të rrugës, grejderi mund të përdoret edhe për korrigjimin e deformimeve, gropëzimeve dhe parregullsive të sipërfaqes, si dhe për rikthimin e profilin të projektuar të rrugës përpara aplikimit të shtresave të asfaltobetonit.

Për shkak të sipërfaqes së konsiderueshme të punimeve dhe nevojës për përgatitjen e një baze të rregullt, të niveluar dhe me pjerrësitë e përcaktuara në projekt, përdorimi i grejderit është teknikisht i justifikuar dhe i domosdoshëm për realizimin me cilësi të punimeve.

Në përfundim, grejderi përbën një nga makineritë kryesore të punimeve të përgatitjes dhe profilimit të rrugës, duke siguruar nivelimin, shpërndarjen dhe profilimin e materialeve të shtresave rrugore dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për ngjeshjen dhe më pas për shtrimin e shtresës së asfaltobetonit.

➤ **Për Asfaltoshtruese 1 (një) copë,**

Përdorimi i asfaltoshtrueses është teknikisht i domosdoshëm për realizimin e shtresës së asfaltobetonit në sipërfaqen e parashikuar në sheshet mes pallateve, me trashësi të projektuar 7 cm. Asfaltoshtruesja është makineria kryesore e specializuar për shtrimin mekanik të përzierjeve asfaltike dhe garanton realizimin e një shtrese të njëtrajtshme, me trashësi, gjerësi dhe profil të kontrolluar sipas kërkesave të projektit.

Asfaltobetoni i prodhuar në impiant transportohet në kantier me kamionët e transportit dhe shkarkohet në bunkerin e asfaltoshtrueses. Nëpërmjet sistemit të ushqimit dhe transportimit të materialit, asfaltoshtruesja e shpërndan përzierjen asfaltike në mënyrë të vazhdueshme përgjatë frontit të punimeve dhe e nivelon atë në trashësinë e përcaktuar.

Përdorimi i asfaltoshtresës mundëson kontrollin dhe ruajtjen e njëtrajshmërisë së shtresës, duke siguruar gjerësinë e projektuar të shtrimit, trashësinë e kërkuar dhe profilin e përshtatshëm të sipërfaqes së rrugës.

➤ **Për Autobitumatriçe 1 (një) copë**

Përdorimi i autobitumatriçës është teknikisht i nevojshëm për realizimin e punimeve të trajtimit bituminoz të sipërfaqes së rrugës përpara shtrimit të shtresës së asfaltobetonit. Duke marrë në konsideratë sipërfaqen e konsiderueshme të punimeve dhe shtrimin e shtresës së asfaltobetonit me trashësi të projektuar 7 cm, aplikimi i kontrolluar dhe uniform i materialit bituminoz është një fazë e rëndësishme e procesit teknologjik të asfaltimit. Përdorimi i autobitumatriçës për hedhjen dhe aplikimin e primerit bituminoz (prime coat) është teknikisht i nevojshëm për përgatitjen e sipërfaqes së bazës së rrugës përpara shtrimit të shtresës së asfaltobetonit.

➤ **Për Rrul ngjeshës me peshë 10- 15 ton 1 (një) copë** është i nevojshëm për ngjeshjen e çakullit, përpara shtrimit të rrugës me asfalt

➤ **Për Rrul ngjeshës asfalti me peshë deri në 5 ton 1 (një) copë** është i nevojshëm për ngjeshjen e sistemimit të asfaltit.

➤ **Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma) 1 (një) copë, Minifadrome (mjet teknologjik me goma) 2 (dy) copë**, janë të nevojshëm për punimet e gërmimit dhe sistemimit, sipas preventivit të punimeve në sasinë të mëdha.

Përdorimi i ekskavatorëve me goma justifikohet nga nevoja për realizimin e gërmimeve mes shesheve të pallateve, në, në zonat e zgjerimit të seksionit rrugor dhe lulishteve, në pjesët ku kërkohet heqja e materialit të papërshtatshëm, si dhe në zona të tjera ku projekti parashikon ndërhyrje në shtresat ekzistuese.

Ekskavatorët me goma janë të përshtatshëm për punime rrugore për shkak të manovrueshmërisë së lartë dhe mundësisë së lëvizjes së shpejtë përgjatë kantierit pa dëmtuar në mënyrë të panevojshme sipërfaqet e asfaltuara ose zonat e aksesit. Pajisja me krah dhe kovë mundëson realizimin e gërmimeve, mbledhjen e materialit dhe ngarkimin e tij në mjetet e transportit.

Ekskavatori me goma mundësojnë organizimin e punimeve në më shumë se një front pune ose përdorimin e tyre në mënyrë të alternuar, duke siguruar vazhdimësinë e punimeve dhe reduktimin e kohëve të pritjes. Njëri ekskavator mund të angazhohet në gërmimin e materialit, ndërsa tjetri mund të përdoret për ngarkim, sistemim, pastrim dhe ndërhyrje në zona të tjera të frontit të punimeve, sipas nevojave të kantierit.

Në mënyrë plotësuese, përdorimi i minifadromës me goma është i nevojshëm për punë të lehta dhe ndihmëse në kantier, si mbledhja e materialit të gërmuar, transporti i tij në distanca të shkurtra, sistemimi i materialeve, pastrimi i sipërfaqes së punimeve dhe nivelimi lokal i materialit.

➤ **Për Minidumper kapaciteti mbajtës 3-8 ton (mjet teknologjik me goma) 2 (dy) cope, dhe Vibrator betoni 1 copë**

Është i nevojshëm për transportin e dheut, zhavorrit, rërës dhe materialeve inerte; transportin e çakullit dhe materialeve të shtresave rrugore brenda kantierit të ndërtimit; largimin e dherave të gërmuara dhe materialeve të prishura; transportin e materialeve gjatë hapjes dhe rehabilitimit të shesheve mes pallateve dhe lulishteve, punime në themele, kanale, trase dhe mbushje, punime në terrene të pjerrëta ose kantiere me hapësirë të kufizuar manovrimi, ngarkim-shkarkim të shpejtë falë karrocërisë vetëshkarkuese (dump).

Kapaciteti 3–8 ton tregon ngarkesën e dobishme që mjeti mund të transportojë.

Lidhur me numrin e mjeteve 2 (dy) cope njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë nuk kemi të bëjmë vetëm me një shesh ndërtim, por me 6 (gjashtë) të tillë, disponimi nga ana e ofertuesve për 2 (dy) mjete minidumper, garanton AK për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë

➤ **Autobetoniere me kapacitet 2-4 m³ (mjet teknologjik me goma)**

Për realizimin e punimeve të parashikuara në projekt, ku është planifikuar përdorimi i rreth 11.26 m³ beton për zërin Shtrese betoni C 16/20, Mur betoni C 16/20 në sasinë 12 m³ është teknikisht i nevojshëm dhe i përshtatshëm përdorimi i autobetoniereve me kapacitet mbajtës 2–4 m³ si mjete teknologjike me goma për transportin dhe furnizimin e kantierit me beton të freskët. Akoma në tej në preventivin e punimeve janë parashikuar punime si Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 në sasinë 200, Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe në sasinë 80 m².

Autobetoniereja është mjet i specializuar për transportimin e betonit të freskët nga impianti i prodhimit deri në kantier, duke ruajtur përzierjen në gjendje homogjene gjatë transportit nëpërmjet kazanit rrotullues. Rrotullimi i kazanit ndihmon në parandalimin e ndarjes së përbërësve të betonit dhe në ruajtjen e uniformitetit të përzierjes deri në momentin e hedhjes.

Në rastin konkret, për një sasi totale prej rreth 30 m³ beton, përdorimi i autobetoniereve me kapacitet 2–4 m³ është i përshtatshëm për furnizimin gradual dhe të kontrolluar të frontit të punimeve. Në varësi të kapacitetit real të mjetit, një autobetoniere mund të transportojë nga 2 deri në 4 m³ beton për ngarkesë.

Nëse përdoret kapaciteti maksimal prej 4 m³ për ngarkesë, për transportimin e 23.26 m³ beton nevojiten teorikisht:

$$23.26 \text{ m}^3 \div 4 \text{ m}^3 = 5.8 \text{ ngarkesa}$$

Pra, praktikisht kërkohen rreth 6 ngarkesa me autobetoniere, me ngarkesën e fundit të pjesshme sipas sasisë së mbetur.

Për kapacitete ndërmjet 2 dhe 4 m³, numri i ngarkesave përcaktohet sipas kapacitetit real të autobetoniereve dhe organizimit të furnizimit të kantierit.

Përdorimi i autobetoniereve është veçanërisht i rëndësishëm për sigurimin e një furnizimi të vazhdueshëm me beton gjatë procesit të hedhjes. Koordinimi i ardhjes së autobetoniereve me ekipin e punës dhe pajisjet e hedhjes dhe vibrimit të betonit shmang ndërprerjet e panevojshme dhe mundëson realizimin e betonimit në mënyrë të njëtrajtshme.

Betoni i transportuar me autobetoniere mund të përdoret për elementët dhe punimet e betonit të parashikuara në projekt, si bazamente, elementë anësorë, kanale, kuneta, bordura, struktura të vogla drenazhimi dhe punime të tjera infrastrukturore që kërkojnë beton të freskët, sipas detajeve teknike të projektit.

Gjatë transportit duhet të respektohen kërkesat teknologjike për betonin, duke përfshirë kohën e transportit, ruajtjen e homogjenitetit të përzierjes dhe kushtet e përshtatshme për hedhjen dhe ngjeshjen e betonit. Pas mbërritjes në kantier, betoni vendoset në elementin përkatës dhe ngjeshet me vibrator sipas procedurës teknologjike.

Për një sasi prej 23.26 m³ beton, përdorimi i autobetoniereve me kapacitet 2–4 m³ është teknikisht dhe operacionalisht i justifikuar, pasi lejon furnizimin e kantierit me sasi të përshtatshme për çdo cikël pune dhe siguron fleksibilitet në varësi të aksesit në kantier dhe ritmit të betonimit.

Në përfundim, autobetoniereja me kapacitet 2–4 m³ është një mjet teknologjik i përshtatshëm dhe i nevojshëm për transportin e betonit të freskët në sasinë totale prej rreth 23.26 m³, duke garantuar furnizim të kontrolluar, ruajtjen e homogjenitetit të përzierjes dhe vazhdimësinë e punimeve të betonimit në kantier.

➤ **Për Kamion me vinci**

Kamioni me vinci përdoret si mjet mbështetës për transportin, ngarkimin, shkarkimin dhe pozicionimin e materialeve, pajisjeve dhe elementëve të ndryshëm gjatë punimeve të rrugës. Është i nevojshëm për mbështetjen e punimeve të gërmimit prej rreth 280 m³, punimeve të betonit prej rreth 30 m³ dhe punimeve të

asfaltimit në sipërfaqen prej 11,080 m², duke lehtësuar lëvizjen dhe vendosjen e pajisjeve e materialeve në frontin e punimeve si për punimet elektrike, shtylla metalike, ndriçues etj. Kamioni me vinç plotëson funksionin e makinerive të tjera dhe siguron organizim, fleksibilitet dhe vazhdimësi të punimeve në kantier.

➤ **Për Autobot uji**

Autoboti i ujit përdoret për lagien dhe ujitjen e shtresave të tokës dhe materialeve granulare gjatë punimeve të nivelimit dhe ngjeshjes, si dhe për kontrollin e pluhurit në kantier. Përdorimi i tij është i nevojshëm gjatë përgatitjes së trupit të rrugës, duke siguruar lagështinë e përshtatshme për ngjeshje dhe kushte më të mira pune. Gjithashtu, autoboti i ujit mund të përdoret për lagien e sipërfaqeve gjatë punimeve të asfaltimit dhe për kufizimin e pluhurit përgjatë frontit të punimeve.

Akoma më tej, kriteri i mësipërm është lënë i hapur për tu plotësuar nga ofertuesit për sa kohë disponimi i tyre lejohet të përmbushet edhe nëpërmjet nënkontraktimit në rastet kur mjetet e kërkuar më poshtë sipas pikës 2.3.8 janë me qera.

Shenim: Gjithashtu vlen te permendet se rruga qe do te rikonstruktohet eshte e vetmia rruge per banoret e zones ndaj gjate punimeve duhet pasur ne vemendje dhe mosbllokimi i saj per kalimin e mjeteve te banoreve. Ndaj dhe mjete me goma qe jane kerkuar duhet te jene te paisura me dokumentacion te rregullt dhe identifikues, sic jane targa, kontroll teknik dhe fizik etj.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

Licensë të shoqërisë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B”. “Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve jo të rrezikshme”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

Licensë të shoqërisë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B”. “Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve jo të rrezikshme”.

Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25m³, si dhe Transport material ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km në sasinë 350 m²) për objektin Rikonstruksioni i Lulishtes dhe W.C-ve punlike prane Bashkise Kucove + Rikonstruksioni i Lulishteve dhe W.C-ve prane Parkut te Ri, Transport dheu me auto deri 5.0 km në sasinë 200 m³ për objektin Rikualifikimi i sheshit mes pallateve prane shkolles Deshmoret e Kombit . Lagja Nr.2, blloku 1 Maj, Transport dheu me auto deri 5.0 km në sasinë 200 për objektin Rikualifikimi i sheshit mes pallateve ne rrugen Niko Hoxha , Lagja Nr.2 , Blloku 11 Shkurti, Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km në sasinë 100 m³ për objektin Rikualifikim i sheshit mes pallateve në rrugën ‘Naftëtari’ pranë ambulancës së lagjes ‘Llukan Prifti’”, dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “ Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ”, parashikohet se “ Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër, konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivti, kërkesa e autoritetit kontraktor për licencim është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, pasi krahas punimeve të gërmimit, operatori ekonomik fitues i kontratës duhet të kryejë edhe transportin e mbetjeve urbane, transportin e dherave dhe inerteve, i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara.

Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- Impiant prodhim asfaltobetoni me QKL (Në pronësi, me qera, ose kontratë furnizimi).
- Nyje Inerte me QKL (Në pronësi, me qera, ose kontratë furnizimi).

Lidhur me kërkesën për Impiant për prodhimin e asfaltit dhe nyje inertesh ku ofertuesit duhet ti disponojnë në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi, njësia e prokurimit argumenton se :

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshem për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshem teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Bazuar dhe në preventivin e punimeve, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të 1 (një) impiant për prodhimin e asfaltit dhe nyje inertesh, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, për sa kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST, duke e lenë të hapur përmbushjen e këtij kriteri në respekt të plotë të ligjit të prokurimit publik, duke rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore duke nxitur njëkohësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik .

Duke pare volume e mëdha të punës që do të kryhen, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë garanci nga ofertuesit për përmbushjen me sukses të çdo zëri të preventivit të punimeve.

Referuar preventivit të punimeve parashikohet shtrimi i rrugës, lulishteve dhe shesheve mes palltave me shtresë cakëlli, dhe shtresë stabilizanti, si dhe zëri shtresë asfaltobetoni 7cm në sasi

të mëdha. Kërkesa e mësipërme e AK është në përputhje me objektin e kontratës duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshem mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo



Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen tek autoriteti kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

- Çertifikatat ISO e kërkuar sipas pikës 2.3.6 të DST.

Argumentim

Referuar karakteristikave që kanë certifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, lidhur me standartet, si dhe mënyrës më anë të së cilës subjektet certifikohen nga trupat e akredituara të certifikimit, njësia e prokurimit gjykon se certifikimet sipas standarteve ISO 9001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente; ISO 14001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalente dhe ISO 39001:2012 mbi "Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor" e vlefshme, ose ekuivalente, dhe ISO 3834-2 (Sistemi e menaxhimit të cilësisë në saldim e vlefshme), ose ekuivalent e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent, janë certifikime ekskluzive, tërësisht individuale dhe që lidhen ngushtë vetëm me plotësimin e standarteve mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë, sistemin e menaxhimit të mjedisit, sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë si dhe sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim, të subjektit i cili certifikohet, pasi i është nënshtruar auditimeve përkatëse nga trupat certifikuese. Pra, përsa kohë certifikimet mbi standartet e mësipërme, janë tërësisht personale të subjekteve, AK vlerëson se, certifikimi lidhur me plotësimin e standarteve nga një subjekt nuk mund të garantojë se subjektet e tjera që mbështetet i plotësojnë këto standarte, pavarësisht tipologjisë të objektit të veprimtarisë së subjektit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

NJËSIA E PROKURIMIT